| | | E sqaron prejardhjen e gjuhës shqipe. | Numëron gjuhët që bëjnë pjesë në grupin e njejtë gjuhësorë (indoevropiane). | Numëro gjuhët që bëjnë pjesë në familjen e njejtë gjuhësore (indoevropiane)? | |
| | Zhvillimi i gjuhës shqipe Dialektet e gjuhës shqipe | REN: Bën dallimin mes dialektit verior dhe jugor. | Në grupin e fjalëve të dhëna bën dallimin e fjalëve të dialekteve të ndryshme. | 1) Dialekti verior ndryshe quhet _____. Dialekti jugor ndryshe quhet _____. 2) Plotëso çiftet e fjalëve me fjalë të dialektit tjetër: çik____, tamël____, magar_____. | |
| | | Transformon fjalët nga gegërishtja në gjuhë letrare. | Dallon fjalët e shkruara në dialekte të ndryshme. | Fjalët në vazhdim shndërroi në gjuhë letrare : udh- _____ shka,_____, i unt, _____, magar,_____. | |
| | Zhvillimi i gjuhës shqipe Shkrimet e para | REN: Identifikon dokumentet e para dhe librin e parë të gjuhës shqipe. | Përmend dokumentet e para të gjuhës shqipe. | 1) Nëse Meshari është vepër e parë e shkruar në shqip, atëherë çfarë është Formula e pagëzimit ? 2) Cilët janë dokumentet e para të gjuhës shqipe: | |
| | | Nje kronologjinë e shkrimeve në gjuhën shqipe. | Nje veprën dhe vitin e librit të parë në gjuhën shqipe. | Si quhet libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe: a) "Bagëti e bujqësi " b) " Meshari " | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|--|---|---|--------|
| | Fonetikë Ndarja e bashkëtingëlloreve sipas zëshmërisë | REN: Identifikon dhe njih çiftet të zëshme dhe pazëshme. | Lidh çiftet sipas zëshmërisë. | Lidhi çiftet e bashkëtingëlloreve sipas zëshmërisë: D S Z T B F V P | |
| | | Dallon bashkëtingëlloret sipas zëshmërisë në: të zëshme, të pazëshme dhe sonore. | Bën ndarjen e duhur të bashkëtingëllore-ve sipas zëshmërisë. | Sipas mënyrës së shqiptimit në cilën grup bëjnë pjesë bashkëtingëlloret e mëposhtme: s, sh, q, k, f a) të zëshme b) të pazëshme c) sonore | |
| | Fonetikë Theksi | REN: Fjalët i shqipton me theks të duhur. | Në mënyrë të drejtë i thekson fjalët njërrrokëshe, dyrrrokëshe dhe shumërrrokëshe. | Gjeje theksin e fjalëve dhe të njëjtat shqiptoi drejtë: punëtor, udhëtar, lule, libër | |
| | | I kupton veçoritë e theksit në gjuhën shqipe. | Në shembull të dhënë e percepton përkatësinë dhe dinamikën e theksit në gjuhën shqipe. | 1. Theksi në gjuhën shqipe është: a) melodik b) dinamik 2. Te foljet theksi bie zakonisht në: _____ | |
| | Morfologji Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme | REN: Identifikon ndarjen e fjalëve në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. | Në grupën me fjalë të dhëna, njih apo veçon fjalë e cila mund ta ndryshoj formën e saj. | Cilët nga shembujt e mëposhtëm mund ta ndryshojnë formën: a) ose b) ndaj c) dorë | |
| | | E kupton ndarjen e fjalëve: në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. | Numëron fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme. | Numroj fjalët e ndryshueshme në gjuhën shqipe: emrat _____, _____, _____, foljet. | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli | | | | | | | | | | | |
|-------|--|---|--|--|--|-------|------|-------|------|--|--|--|--|--|--|--|
| | Morfologji Përdorimi i drejtë i togjeve të bashkëtingëlloreve | REN: Identifikon togjet e bashkëtingëlloreve (mb, nd, ng, etj). | Përmend togjet më të shpeshta të bashkëtingëlloreve. | Shkruaj disa fjalë ku përdoren togjet e bashkëtingëlloreve -mb dhe -nd: _____ , _____ , _____ , _____ , _____ . | | | | | | | | | | | | |
| | | Di t'i përdorë në gjitha pozitat e fjalës, në fillim, mes dhe fund të saj. | Përdorë drejtë togjet e bashkëtingëlloreve. | Shkruaj fjalë ku togjet e bashkëtingëlloreve -mb dhe -nd hasen në fillim, mes ose në fund të fjalës: _____ , _____ , _____ , _____ . | | | | | | | | | | | | |
| | Morfologji Kategoria e shquarsisë së emrave | REN: E kupton kategorin e shquarsisë tek emrat. | Në tekst të shkurtër njih shquarsin e emrave. | Unë kam një vëlla. Vëllau im është më i madhë Cili emër është i shquar: a) vëlla b) vëllau | | | | | | | | | | | | |
| | | Sqaron se si formohet emri i shquar. | I përmend prapashtesat të emrave të shquar sipas gjinisë dhe numrit. | Cilat mbaresa përdoren për emrat e gjinisë femërore njëjës : a) -a , -ja. b) -i, -u, | | | | | | | | | | | | |
| | Morfologji Folja- Kategoria gramatikore e mënyrës | REN: E kupton kategorin gramatikore të mënyrës së foljes (mënyra dëftore, urdhërore, kushtore). | Në fjalinë e dhënë, njih kategorin gramatikore të mënyrës së foljes. | Punoni më mirë! Cilën mënyrë e gjeni tek folja Punoni: a)dëftore b) urdhërore c) kushtore | | | | | | | | | | | | |
| | | Në mënyrë të drejtë përdorë mënyrën dëftore, urdhërore, kushtore te foljet. | Transformon fjalitë nga një mënyrë në tjetër. | Fjalinë nga mënyra dëftore shëndrroje në mënyrën urdhërore dhe kushtore . Vesa erdhi tek unë. _____ (mënyra urdhërore) _____ (mënyra kushtore) | | | | | | | | | | | | |
| | Morfologji Folja- Veta, numri dhe koha | REN: Dallon kategorin gramatikore të vetës së foljes. | Në fjalinë e dhënë, njih kategorinë e vetës së foljes. | Folja shkruaj është: a) v. 1- unë b) v. 2 -ti c) v. 3 -ai/ajo | | | | | | | | | | | | |
| | | REN: Dallon kategorin gramatikore të numrit së foljes . | Në fjalinë e dhënë njih kategorinë e numrit te foljet. | Unë shkruaj bukur. folja shkruaj është: a) njëjës b) shumës | | | | | | | | | | | | |
| | | REN: Dallon kategorin gramatikore të kohës së foljes. | Në fjalinë e dhënë, njih kategorinë e kohës së foljes. | Folja shkruaj është: a) në kohën e tashme b) kohën e kaluar c) kohën e ardhme | | | | | | | | | | | | |
| | | Analizon foljet dhe kategoritë gramatikore të tyre. | Te foljet e dhëna bën analizë të kategorive gramatikore. | Plotësoni kërkesat në tabelën e dhënë nga fjalitë e mëposhtme: a) Burimi doli në rrugë. b) Menjëherë shkroi detyrat. c) Ajo don të shkon me të. | <table border="1"> <thead> <tr> <th>folja</th> <th>veta</th> <th>numri</th> <th>koha</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | folja | veta | numri | koha | | | | | | | |
| | folja | veta | numri | koha | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|---|--|--|--------|
| | Sintaksë Kryefjala dhe kallëzuesi | REN: E kupton rolin e kryefjalës (si kryersi i veprimit) dhe të kallëzuesit (si veprim) në fjali. | Te fjalitë e thjeshta me pyetjet kush, cili, cila e gjen kryefjalën dhe me pyetjet ç'bën e gjen kallëzuesin. | Burimi këndon. Përgjigju pyetjeve: Kush këndon? _____ (kryefjala) Çka bën Burimi? _____ (kallëzuesi) | |
| | | Te fjalia e thjeshtë analizon kryefjalën dhe kallëzuesin. | Përmendë kryefjalën dhe kallëzuesin. | Pushimet po mbarojnë. Kryefjala te fjalia e lartëpërmendur është: a) Pushimet b) po mbarojnë Kallëzuesi te fjalia e lartëpërmendur është: a) Pushimet b) po mbarojnë | |
| | Sintaksë Fjalia e thjeshtë | REN: Formon fjali të thjeshtë me pjesët kryesore të fjalisë: kryefjalën dhe kallëzuesin. | Nga kryefjala dhe kallëzuesi i dhënë, formon fjali të thjeshtë . | Shkruaje një fjali të thjeshtë: Kryefjala- Sanja, kallëzues- këndon _____ | |
| | | Sqaron se kryefjala është gjymtyrë kryesore e fjalisë. | Përmendë fjali me kryefjalë por pa kallëzues. | Shkruaj fjali vetëm me kallëzues: _____ | |
| | Morfologji Ndajfolja e kohës, vendit dhe mënyrës | REN: Njeh ndajfoljen e kohës te fjalia e thjeshtë. | Në fjalinë e thjeshtë njeh ndajfoljen e kohës. | Aida erdhi sot. Në fjalinë e mëposhtme ndajfolje kohe është: a) Aida b) erdhi c) sot | |
| | | Zgjeron fjalinë e thjeshtë me ndajfolje kohe. | Fjalinë e thjeshtë e plotëson me ndajfolje kohe, e cila i përgjigjet pyetjes: Kur ka ndodh veprimi? | Plotëso fjalinë e mëposhtme me ndajfolje kohe: _____punon Agimi. (kur?) | |
| | | REN: Njeh ndajfoljen e vendit te fjalia e thjeshtë. | Në fjalinë e thjeshtë njeh ndajfoljen e vendit. | Makina u kthye djathtas. Në fjalinë e mëposhtme ndajfolje vendi është : a) Makina b) u kthye c) djathtas | |
| | | Zgjeron fjalinë e thjeshtë me ndajfolje vendi. | Fjalinë e thjeshtë e plotëson me ndajfolje vendi, e cila i përgjigjet pyetjes: Ku ka ndodh veprimi? | Plotëso fjalinë e mëposhtme me ndajfolje vendi: Taipi punon _____. (ku?) | |
| | | REN: Njeh ndajfoljen e mënyrës te fjalia e thjeshtë. | Në fjalinë e thjeshtë njeh ndajfoljen e mënyrës. | Blendi shkruan bukur. Në fjalinë e mëposhtme ndajfolje mënyre është : a) Blendi b) shkruan c) bukur | |
| | | Zgjeron fjalinë e thjeshtë me ndajfolje mënyre. | Fjalinë e thjeshtë e plotëson me ndajfolje mënyre, e cila i përgjigjet pyetjes: Si ka ndodhë veprimi? | Plotëso fjalinë e mëposhtme me ndajfolje mënyre: Blendi vrapon _____. (si?) | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|--|---|--|--|--------|
| | Sintaksë Fjalë e përbërë | REN: Sqaron strukturën e fjalisë së përbërë. | Nga fjalitë e përmendura njeh se cila fjali është e thjeshtë e cila e përbërë. | Cila nga fjalitë e mëposhtme është e përbërë: 1) E dogji fushën. 2) Me vështirësi e dogji fushën e thatë dhe iku. | |
| | | Fjalinë e përbërë e ndan në gjymtyrë- fjali. | Fjalinë e përbërë e ndanë në gjymtyrë- fjali, duke u nisur nga rregulla sa kryefjalë kemi aq edhe gjymtyrë-fjali kemi. | E dogji fushën, e terhoqi makinerin dhe iku për shtëpi. Fjalë e përbërë është ka: a) 2 gjymtyra-fjali b) 3 gjymtyra-fjali | |
| | Drejtëshkrimi dhe drejtëshqiptimi Shkurtesat | REN: I njeh shkurtesat nëpër tekste. | Nga një sërë përgjigje të ofruara njeh domethënien e shkurtesave. | Shkurtesa mr. do të thotë: a) magjistër b) magjistër c) mjeshtër | |
| | | Më së shpeshti shfrytëzon shkurtesa të përdorura gjatë të shprehurit me shkrim. | Shpeshherë shkurtesat e shfrytëzuara i zbaton gjatë të shkruarit. | -Shkruaj shkurtesat e fjalëve: -shkurtesa e fjalës numër _____ -shkurtesa e fjalës Republika e Maqedonisë _____ -shkurtesa e fjalës e tjerë _____ | |
| | Drejtëshkrimi dhe drejtëshqiptimi Fjalë të shkruara drejtë/ Togfjalësh | REN: Njeh fjalët e përbëra të shkruara drejtë | Nga përgjigjet e ofruara zgjedh fjalët e përbëra të shkruara siç duhet. | Rretho fjalë e shënuara drejtë: a) kilo meter b) kilometër a) meimiri b) më i mirë a) shumelloje b) shumë lloje | |
| | | Përdorë togfjalëshin. | Jep shembull se si shkruhet një togfjalësh | Shkruaj një togfjalësh:_____. | |
| | Drejtëshkrimi dhe drejtëshqiptimi Shenjat e pikësimit në gjuhën e shkruar | REN: Përdorë shenjat e pikësimit: dy pika dhe thonjëzat në gjuhën e shkruar. | Në mënyrë të drejtë përdorë shenjat e pikësimit. | Në fjalinë e dhënë përdorë shenjat e pikësimit: dy pika, pikëpyetjen, pikën Ai pyeti A do arrish në kohë | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|---------|--|--|--|--|--------|
| LETËRSI | Ndarja e letërsisë Ndarja e gjinive letrare: lirika (poezia), epika (proza), drama (teksti dramatik) | REN: Njeh karakteristikat e jashtme të lirikës (poezia është e shkruar në rreshta/vargje të shkurtra). | Tekstin e dhënë në bazë të karakteristikave të jashtme (vargje-poezi) e njeh si pjesë e gjinisë lirike. | ATDHEU O atdhe! Më je i dashur sa më s'ka Me je nënë, me je motër, me je vëlla Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti me je, Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe. Teksti është shkruar në vargje dhe është: a) poezi b) prozë c) tekst dramatik | 3 |
| | | Sqaron specifikat e brendshme (vizualitetin, muzikalitetin dhe emocionet) të tekstit lirik. | Tekstin e dhënë me plotë emocione, pejsazhe poetike dhe rimë/ritëm e karakterizon si lirikë. | ATDHEU O atdhe!Më je i dashur sa më s'ka Me je nënë ,me je motër ,me je vëlla Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti me je, Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe. Në tekst janë të përfaqësuara emocionet, rima dhe imazhet poetike, që do të thotë se i përket gjinisë letrare: a) lirike b) epike c) dramatike | |
| | | REN: Njeh karakteristikat e jashtme të epikës (proza është e shkruar në rreshta të gjatë). | Tekstin e dhënë në bazë të karakteristikave të jashtme (rreshta të gjatë-prozë) e njeh si pjesë e gjinisë epike. | Asi kohe, qyteti Korça kishte zënë të lulëzonjë, duke qenë më parë një qyteti i vogël edhe i padëgjuar siç është sot, po njerëzia dridheshin nga frika se mos kanë gjithë atë fat që kishin edhe të tjerët të cilët ngryseshin të gjallë e gdhieshin të vdekur. Teksti është i shkruar në vargje të gjata dhe është: a) poezi b) prozë c) tekst dramatik | |
| | | Sqaron specifikat e brendshme (përfaqësim të personazheve dhe ngjarjeve) të tesktit epik . | Tekstin e dhënë, në të cilin ka personazhe dhe ngjarje, e karakterizon si epik. | Nëpër fytyrën dikur të njomë e të bukur, të shëndoshë e të plotë, si lulja në mëngjesin e pranverës plot rreze të këndshme dielli, ishin kryqëzuar tash do rrudha që ia kishin bërë koha dhe vuajtjet, thua se në atë mënyrë i kishte shënuar çdo vuajtje kujtimet e veta me nga një rrudhë në fytyrën e saj. Në tekst ka ngjarje dhe personazhe, dmth bën pjesë në gjininë letrare të: a) lirikës b) epikës c) dramtikës | |
| | | REN: Njeh karakteristikat e jashtme të dramës (teksti dramatik është i ndarë në role/persona). | Tekstin e dhënë në bazë të karakteristikave të jashtme (teksti i ndarë në role-tekst dramatik) e njeh si vepër të gjinisë dramatike. | Babai: "Eja në tavolinë për të ngrënë!" Djali : ..Tani nuk kam uri" Babi : ..Eja tani, nuk mund të hamë kush kur te don" Teksti ndahet në role dhe i takon : a) poezisë b) prozës c) tekstit dramatik | |
| | | Sqaron specifikat e brendshme të tekstit dramatik (e dedikuar për të performuar në skenë). | Tekstin e dhënë, i cili është i ndarë në personazhe që interpretojnë në skenë, e karakterizon si dramë. | Babai: "Eja në tavolinë për të ngrënë!" Djali : ..Tani nuk kam uri" Babi : ..Eja tani, nuk mund të hamë kush kur te don" Në tekst është shkruar për performancën e një skene, prandaj i takon gjinisë letrare: a) lirike b) epike c) dramatike | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|--|--|--|---|--|--------|
| | Prozë Dialogu/ monologu | REN: Njeh monologun dhe dialogun në tekstin dramatik. | Tekstin e dhënë dramatik e njeh kur personazhi bisedon me vetveten (monolog) dhe kur bashkëbisedojnë dy e më shumë personazhe (dialog). | NICA: „Unë nuk e di i cilës ushtrie je ti, sepse asnjehere nuk i kam njohur rrobat e ushtrisë dhe tani jam shumë plakë për t’i mësuar...” Teksti i lartëpërmendur është: a) dialog b) monolog | |
| | | Jep shembull për monolog dhe dialog. | Nga teksti i dhënë jep shembull për dialog dhe monolog. | Babai: “Eja në tavolinë për të ngrënë !” Djali : „Tani nuk kam uri” Babi : „Eja tani, nuk mund të hamë kush kur te don” Në tekstin e dhënë dramatik tregimi është: a) monolog b) dialog | |
| Poezia Llojet e këngëve lirike sipas motivit: patriotike, peisazhit, dashurie, shoqërore. | REN: Njeh motivin te këngët patriotike. | Këngën e dhënë e përcakton sipas motivit që frymëzon shkrimtarin që t’i shkruaj dashurisë ndaj atdheut. | | O moj Shqypni O moj Shqypni, e mjera Shqypni, Kush të ka qitë me krye n’hi? Ti ke pas kenë një zojë e randë, Burrat e dheut të thirrshin nanë. Ke pasë shumë t’mira e begati, Me varza t’bukura e me djelm t’ri, Gja e vend shumë, ara e bashtina, Me armë të bardha, me pushkë ltina, Me burra trima, me gra të dlira; Ti ndër gjith shoqet ke kenë ma e mira. .. Sipas motivit, poezia është: a) patriotike b) peisazhit c) dashurisë d) shoqërore (sociale) | |
| | Shkruan këngë të shkurtër patriotike. | Shkruan këngë të shkurtër patriotike në temën e dhënë. | | Shkruani disa vargje mbi këtë temë: “Vendi im” | |
| | REN: Njeh motivin te këngët për natyrën. | Këngën e dhënë e përcakton sipas motivit që e frymëzon shkrimtarin që t’i shkruaj bukuri të natyrës. | | “Malet me gurë, fushat me bar shumë, arat me grurë me tutje një lumë” Sipas motivit poezia është:a) patriotike b) peisazhit c) dashurisë d) shoqërore (sociale) | |
| | Shkruan këngë të shkurtër për natyrën | Shkruan këngë të shkurtër për natyrën në temën e dhënë. | | Shkruani disa rreshta në temën: “Vjeshtë e artë” | |
| | REN: Njeh motivin në këngët e dashurisë. | Këngën e dhënë e përcakton sipas motivit i cili e frymëzon shkrimtarin që të shkruaj për dashurinë ndaj të dashurës/it. | | Vijnë vashat valle-valle Gushë-e gji-stolisura Nje pellumb, një sysorkadhe Sec vjen m`e mbollisura. C`m`i ka hije shtat`i hedhur, Hije kraharuari, Pa fillon me zë të dredhur Motra së kënduari Sipas motivit poezia është :a) patriotike b) peisazhit c) dashurisë d) shoqërore (sociale) | |
| | Shkruan këngë të shkurtër dashurie. | Shkruan këngë të shkurtër dashurie në temën e dhënë. | | Shkruani disa vargje mbi këtë temë: “Dashuria e trishtë” | |
| | REN: Njeh motivin në këngët sociale (shoqërore). | Këngën e dhënë e përcakton sipas motivit i cili e frymëzon shkrimtarin që ta shkruaj ndjenjat e mbrendshme të shkrimtarit. | | Kafshatë që s’kapërdihet asht, or vlla, mjerimi, kafshatë që të mbetë në fyt edhe të ze trishtimi kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin të tanë jetën e vet derisa të vdesin. E mbi ta n’ajri, si në qesendi, therin qiellën kryqat e minaret e ngurta, profetët dhe shejtët në fushqeta të shumngjyrta shkëlqejnë. E mjerimi mirfilli ndien tradhti. Sipas motivit poezia është: a) patriotike b) peisazhit c) dashurisë d) shoqërore (sociale) | |
| | Shkruan këngë të shkurtër sociale. | Shkruan këngë të shkurtër sociale në temën e dhënë | | Shkruani disa vargje mbi këtë temë: “Varfëria dhe uria” | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------------------------------|---|--|--|---|--------|
| | Poezia Figura stilistike: epiteti, anafora, epifora | REN: E kupton rolin e figurës stilistike epitetin, e cila e pasuron imazhin e këngës. | Në vargjet e dhëna, njih figurën stilistike të epitetit | gjumi i thellë Akil këmbëshpejti Dhelpra dinake Toka e zezë Fjalët e nënvizuara janë : a) anafora b) epifora c) epitete | |
| | | Përdorë epitete gjatë të shkruarit e këngëve. | Shkruan këngë të shkurtra duke përdorur epitete. | Shkruani disa vargje dhe theksoni epitetet: | |
| | | REN: E kupton rolin e figurave stilistike në poezi, anaforën dhe epiforën, me qëllim rritjen e muzikalitetit dhe fuqinë shprehëse. | Në vargjet e dhëna, njih figurat stilistike: epitetin, anaforën, epiforën. | Anës detit i pa larë, Anës dritës i paparë, Pranë sofrës i pangrënë, Pranë dijes i panxënë, Fjalët e nënvizuara janë : a) anafora b) epifora c) epitete | |
| | | Përdorë anaforën dhe epiforën gjatë të shkruarit e këngëve | Shkruan këngë të shkurtra duke përdorur anaforën dhe epiforën. | Shkruani disa vargje dhe theksoni anaforën dhe epiforën. | |
| Poezia Këngët epiko-lirike | REN: Identifikon këngë epiko-lirike, në cilat përveç personazheve dhe ngjarjeve (elemente epike) ka edhe emocione të forta (elemente lirike). | Në vargjet e dhëna, njih elemente epike dhe lirike si dhe karakterizon këngën si këngë epiko-lirike. | BALA Mori bijë, bijë e Lalës, Moj e bukur, e trishtuar, Pse m'kujton motin e shkuar? Ja, ku megjulla e errët Rrokulliset mal më mal Sa lind dielli malit t'Gropës, Tundet, qesh i thelli shpat. Porsi ti, e bardhë, e kthjellët Në poezi ka personazhe dhe ngjarje, por ka edhe ndjenja të forta (mërzi), dmth. poezia bën pjesë në grupin e këngëve: a) lirike b) epike c) epiko- lirike | | |
| | Shkruan këngë epiko-lirike | Shkruan këngë epiko-lirike në temën e dhënë | Shkruani një këngë lirike-epike në temën: "Një hero i panjohur" | | |

| FuSha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-----------------------------|--|---|---|---|--------|
| TËSHPREHURIT DHE KRIJIMTARI | Të shprehurit me gojë Biseda si lloj komunikimi | REN: Bisedon siç i ka hije, formulon pyetje të sakta si dhe jep përgjigje adekuate. | Në situatën e dhënë përdorë fjalë përkatëse për një komunikim siç i ka hije. | Si i drejtoheni një personi në moshë, një personi të panjohur, një personi në detyrë? a) Ju si jeni? b) Ti si je? | 3 |
| | | Bisedën e përshtat sipas situatës dhe bashkëbiseduesve. | Në situatë të dhënë, me kujdes i zgjedh shprehjet e kërkimfaljes. | Me çfarë kërkimfalje do të kishit ndërprerë dikë gjatë mbledhjes? a) Më falni që ju ndërpres! b) Më lejoni t'ju pyes diçka! | |
| | Të shprehurit me gojë Intervista | REN: E kupton domethënien e intervistës. | Në revistën e ofruar zbulon faqe nga një intervistë të bërë me ndonjë personalitet. | Shikoni revistën dhe veçoni një intervistë me një person | |
| | | Gatishmëria për të realizuar një bisedë/intervistë për punësim. | Realizon biseda zyrtare me punëdhënës si dhe pyetjeve të parashtruara u përgjigjet në mënyrë konkrete dhe siç i ka hije . | Çfarë keni punuar në 5 vitet e fundit?: a) gjithçka b) kam punuar në një fabrikë ricikluese për plastike për 3 vjet dhe pas mbylljes kam punuar si ndihmës- automekaniku. | |
| | Të shprehurit me shkrim Raporti | REN: E sqaron nevojën e të shkruarit raport. | Tregon se cili është roli më i rëndësishëm i një raporti. | Raporti shkruhet për të : a) mbetur e dokumnetuar ndonjë ngjarje b) për t'u publikuar në media | |
| | | Shkruan raport nga një ngjarje. | Shkruan raport nga një ngjarje duke iu përgjigjur pyetjeve më të rëndësishme, si : kush, kur, ku, si dhe pse. | Shkruani një raport nga ngjarja e sotme duke u përgjigjur pyetjeve më të rëndësishme: kush, kur, ku, si, pse. p.sh.: Më 27 maj 2018, në ambientet e shkollës, u mbajt një takim midis kandidatëve dhe mentorëve të tyre. Në takim u diskutuan shumë çështje dhe bashkarisht u vendosë që me 31 maj 2018 të jetë data e provimit . | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 3 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli | |
|------------------|--|--|---|---|------------|----------------------|
| KULTURË E MEDIAS | Shfaqje teatrale Roli i regjisorit, aktorit, skenografit, kostumografit | REN: E kupton rolin e regjisorit, aktorit, skenografit, kostumografit në një shfaqje teatrale. | Nga përgjigjet e ofruara zgjedh përgjigjen e duhur me anë të së cilës sqaron punën që bën regjisorit, aktori, skenografi, kostumografi në një shfaqje teatrale. | Lidh profesionin me punën që bëjnë | 3 | |
| | | | | regjisorit | | e përgatit skenën |
| | | | | aktori | | i përzgjedh kostumet |
| skenografi | bën regjinë e shfaqjes | | | | | |
| | | | | kostumografi | luan rolet | |
| | | Komenton shfaqjen e shikuar teatrale. | Jep mendimin e tij në suksesin e roleve të të gjithë pjesëmarrësve në shfaqjen teatrale. | Sa ishte mbresëlënëse dhe e suksesshme vendosja e skenarit në shfaqjen teatrale? | | |
| | Mediateka Mediateka | REN: Bën dallimin mes bibliotekës dhe mediatekës. | Dallon shërbimet e bibliotekës nga shërbimet e mediatekës. | Në mediatik mund të përdoren: a) libra dhe gazeta b) mediat elektronike dhe të shtypura | | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 4 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|---|---|--|--------|
| GJUHË | Zhvillimi i gjuhës shqipe Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shek.XX | REN: Identifikon shkrimtarët më të njohur të kësaj periudhe. | Ka njohuri për shkrimtarët e gjysmës së parë të shek. XX. | Cilët janë shkrimtarët më të njohur të letërsisë së parë të shek.XX ? | 4 |
| | | Njih vepritarinë si dhe veprat më të njohura të tyre (Gjergj Fishta, Fan S.Noli, Migjeni, Faik Konica, Lasgush Poradeci etj.) | Përmendë kryeveprat e shkrimtarëve të kësaj periudhe. | Shkruaj kryeveprat e shkrimtarëve : Migjeni _____, Gjergj Fishta _____, Fan S. Noli _____. | |
| | | Njih temat e trajtuara të shkrimtarëve të kësaj periudhe. | Analizon veprat e shkrimtarëve të kësaj periudhe me tematika të ndryshme. | 1) Cila temë trajtohet në veprën "Poema e mjerimit" 2) Cila tematik poetike zë pjesë më të madhe në poezit e shkrimtarëve të gjysmës të parë të shek. XX. | |

| Fusha | Tema/Përmbajta | Rezultate nga të nxënit për nivelin 4 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|--|--|--|--|--------|
| | Fonetikë Ndarja e bashkëtingëlloreve sipas vendit të formimit | REN: Identifikon ndarjen e bashkëtingëlloreve sipas vendit të formimit në: buzore, dhëmbore, alveolare, qjellzore etj. | Bën ndarjen e drejtë të bashkëtingëlloreve sipas vendit të formimit. | Bashkëtingëlloret sipas vendit të formimit ndahen në: a) zanore dhe bashkëtingëllore b) buzore, dhëmbore, alveolare, qjellzore | |
| | | Dallon bashkëtingëlloret sipas vendit të formimit. | Gjatë shqiptimit të bashkëtingëllores, vet vlerëson se në cilën grup bën pjesë bashkëtingëlloret e artikuluar. | Sipas vendit të formimit, në cilin grup të bashkëtingëlloreve bën pjesë bashkëtingëlloret B? a) buzore b) dhëmbore | |
| | Fonetikë Bashkëtingëlloret h | REN: Identifikon bashkëtingëlloren h në fillim, mes dhe në fund të fjalës. | Drejtë përdorë bashkëtingëlloren h nëpër fjalë të ndryshme. | Në cilën pozitë bashkëtingëlloret h përdoret më rrallë: a) në fillim të fjalës b) në mes të fjalës c) në fund të fjalës | |
| | | Përdorë bashkëtingëlloren h te një numër fjalësh të burimit turk: haber, hajdut, hajmali, hajvan, hak, hall, hallë, hallkë, hallvë, hamall, hambar, haraç, harxh, hasëll, hasm-i, hava, havan, hem... hem, hendek, hiç, hile, hise | Te fjalët me prejardhje turke gjen një sërë fjalë që fillojnë me bashkëtingëlloren h, e që të njejtat huazime në gjuhën maqedone dalin pa këtë bashkëtingëllore. | Si shkruhen fjalët në vazhdim: a) hallall) b) allall a) haxhillëk b) axhillak a) Araçin b) Haraçinë a) ajduk b) hajdut | |
| | Fonetikë Bashkëtingëlloret në fund të fjalës | REN: Shkruan drejtë fjalët me bashkëtingëllore të zëshme në fund të fjalës | Jep shembuj nga përdorimi i tyre dhe tregon se ata shqiptohen ashtu siç shkruhen | A janë të përdorura drejtë bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalëve: elb, gjemb, u kalb, fund, breg a) po b) jo | |
| | | Sqaron bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës. | Bën përdorimin e drejtë të bashkëtingëlloreve në gjitha vendet e saja në fjalë. | Fjalët e mëposhtme shkruhen me s apo z në fund të fjalës: a) barkas, mëngjes b) barkaz, mëngjez | |

| Fusha | Tema/Përmbajta | Rezultate nga të nxënit për nivelin 4 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|--|--|--|--|--------|
| | Fonetikë Llojet e theksit | REN: Identifikon se ekzistojn lloje të ndryshme të theksit në gjuhën shqipe. | Vjen në përfundim se disa fjalë theksohen më ndryshe. | Ku bie theksi tek emri dora? a) në rrokjen e parë b) në rrokjen e dytë | |
| | | Di vendin e theksit në fjalë. | Drejtë i thekson fjalët me theks fundor, parafundor dhe ato tejfundor. | Cilit lloj të theksit i takojnë foljet e mëposhtme: mësój, lexój, shikój, mendój? a) fundor b) tejfundor c) parafundor | |
| | Morfologji Folja - Format e pashtjelluara | REN: Identifikon formën e pashtjelluar të foljes - pjesorën. | Drejtë përdorë pjesorën në fjali si dhe me ndihmën e tyre formon kohët e përbëra. | Si bën pjesorja e foljes lexoj në kohën e kryer: _____ | |
| | | Drejtë përdorë formën e pashtjelluar të paskajorës. | Njih formën e pashtjelluar të paskajorës dhe di formimin e saj me pjesore + fjalëzave përkatëse. | Paskajorja e foljes lexoj bën: a) duke lexuar. b) kam lexuar c) për të lexuar | |
| | | Transformon foljet nga forma e pashtjelluar e paskajorës në atë të përcjellorës. | Me anë të transformimit të formave të pashtjelluara ndryshon edhe kuptimin e fjalive. | Foljen lexoj transformo nga forma e pashtjelluar e përcjellorës në paskajore: duke lexuar (përcjellore) _____ (paskajore) | |
| | Morfologji Shkallët e mbiemrave | REN: Identifikon rregullat për shkallët e mbiemrave. | Numëron elementet formuese për shkallët e mbiemrave. | Me cilët prapashtesa formohen shkallët krahasore dhe sipërore e mbiemrit: a) -më, -më të b) -ndër, -mbi | |
| | | Gjatë të shprehurit, përdorë drejtë shkallën krahasore dhe sipërore. | Në përbërje të fjalisë, drejtë i shkallëzon mbiemrat. | Cila është shkalla e parë e mbiemrit: a) krahasore b) pohore | |

| Fusha | Tema/Përmbajta | Rezultate nga të nxënit për nivelin 4 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|-------------------------------------|---|---|---|--------|
| | Morfologji Rasat e gjuhës shqipe | REN: Identifikon llojet e rasave në gjuhën shqipe. | Emrin e dhënë e lakon në rasa. | Emrin shoku lakoe në rasa: emërore _____ kallëzore _____ gjinore _____ rrjedhore _____ dhanore _____ | |
| | | Në mënyrë të drejtë përdorë gjitha rasat e gjuhës shqipe. | Në mënyrë të drejtë përdorë: rasën emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore. | Në shembujt e mëposhtëm tregoi rasat: Nxënësi shkruan _____ Libri i nxënësit është i pastër. _____ Nxënësit i dhuruan një libër. _____ | |
| | | Rasat për t'i kuptuar më lehtë, shkruan edhe pyetjet me të cilat gjinden ata. | Me pyetjet: kush, cili, i kujt, e kujt, kujt, cili, kë, cilin, prej kujt, prej cilit, i gjen rasat e ndryshme të gjuhës shqipe. | Me pyetjet prej kujt, prej cilit gjindet: a) rasa emërore b) rasa dhanore c) rasa rrjedhore | |
| | Sintaksë Llojet e kallëzuesit | REN: Identifikon kallëzuesin si pjesë e fjalisë që tregon gjendje apo veprim të kryefjalës. | Njih mënyrën e formimit të llojeve të kallëzuesit. | Sa kallëzues përmban fjalia: Një gjuhë, një flamur, një komb, një shtet. _____ | |
| | | Njih këto lloj kallëzuesi: kallëzues foljor i thjeshtë, kallëzues foljor i përbërë kallëzues emëror. | Bën përdorimin e drejtë të llojeve të kallëzuesit në fjali. | Dy prej luanëve ishin meshkuj. Në fjali e mëposhtme është përdorur: a) kallëzuesi foljor i thjeshtë b) kallëzuesi foljor i përbërë c) kallëzuesi emëror | |
| | | Përdorë drejtë llojet e kallëzuesve. | Dallon llojet e kallëzuesve. | Ç'farë lloj kallëzuesi kemi te fjalia e parë dhe ç'farë te e dyta: a) Ti më munde. _____ b) Po djali sa zinte recitonte, harronte vjershën. _____ | |
| | Sintaksë Atribut | REN: Identifikon rolin dytësor të atributit. | Vlerëson se fjalia pa atribut mund të ekzistoj. | A mund të ekzistoj fjalia pa atribut? a) po b) jo | |
| | | I identifikon atributet. | Në një fjali të thjeshtë njih atributet. | Nënvizo atributet në fjalën e mëposhtme: Dje nga Samiu bleva domate të shijshme vendore. | |
| | | Përdorë attribute për shprehje më precize dhe larmishme . | Plotëson emrin e dhënë me attribute përkatëse me qëllim të fitoj në saktësi dhe laramani . | Shto tre atributet për emrin ndërtesa _____, _____ ndërtesa | |

| Fusha | Tema/Përmbajta | Rezultate nga të nxënit për nivelin 4 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|---|---|--|--------|
| | Sintaksë Apozicion | REN: Identifikon rolin dytësor të apozicionit. | Vlerëson se fjalia pa apozicion mund të ekzistoj. | A mund të ekzistoj fjalia pa apozicion? a) po b) jo | |
| | | Identifikon apozicionin. | Në një fjali të thjeshtë njih apozicionin. | Nnënvizo apozicin në fjalinë e mëposhtme: Shkupi, kryeqyteti i R.M.-së, është qendër administrative e kulturore në rajon. | |
| | | Përdorë apozicionin për shprehje më precize. | Shkruan fjali të thjeshtë duke përdorur apozicionin. | Shkruaj fjali me apozicion: _____. | |
| | Fjalori dhe stili Neologjizma | REN: Identifikon neologjizma- fjalë apo shprehje të reja. | Në një grup të caktuar fjalësh, ai njih neologjizmat. | Cila nga fjalët e mësipërme është neologjizëm: dollar, bashkëbisedim, kompjuter, pasul | |
| | | Përdorë neologjizmat dhe di domethënien e tyre. | Jep shembuj të fjalisë që posedon neologjizma. | Shkruani një fjali me neologjizëm dhe nënvizoni të njëjtën: _____ | |
| | Drejtëshkrimi Përdorimi i vizës, apostrofit, kllapave | REN: Identifikon shenjat drejtëshkrimore. | Saktë i lidh shenjë me emërtimin e saj. | Lidhi shenjat drejtëshkrimore me emërtimet e drejta të tyre: () - kllapat, viza, apostrofi, | |
| | | Në mënyrë të drejtë përdorë shenjat drejtëshkrimore. | Në fjalinë e dhënë, drejtë përdorë shenjat drejtëshkrimore. | Në fjalinë e mëposhtme përdorni drejtë shenjat drejtëshkrimore: _____ | |

| FuSha | Tema/Përmbajta | Rezultate nga të nxënit për nivelin 4 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|---------|---|---|---|--|--------|
| LETËRSI | Poezia Karakteristikat e poezisë popullore dhe autoriale Lahuta e Malcise "Cubat" Gjergj Fishta | REN: Identifikon poezi popullore dhe autoriale. | Pjesët e dhëna nga kënga i vlerëson si vepër e poezisë popullore ose autoriale. | Ndihmò, Zot, si m'kë ndihmue! Pesëqind vjet kishin kalue Çese të buk'rën ketë Shqypni Turku e mbate në robni, krejt tu' e là t' mjerën në gjak, frymën tue ia xanun njak, e as tu' e lanë, jo, dritë me pà: kurr të keqen pa ia dà: Vargjet i përkasin: a) poezisë autoriale b) poezisë popullore | 4 |
| | | Bën ndarjen e poezisë sipas krijuesit në: autoriale dhe popullore | Përmend ndarjen e poezisë sipas krijuesit në: popullore dhe autoriale | Fragment i cilës vepër dhe shkrimtar janë vargjet e lartëpërmendura: 1. Lahuta e Malcise-"Cubat" nga Gjergj Fishta 2. Fshati im nga Çajupi | |
| | Poezia Organizimi i strofave sipas numrit të vargjeve | REN: Emërton strofa sipas numrit të vargjeve të përdorura në strofë | Emërton strofa sipas numrit të vargjeve | Si quhet strofa që përbëhet nga 2 vargje _____ Si quhet strofa që përbëhet nga 3 vargje _____ Si quhet strofa që përbëhet nga 4 vargje _____ | |
| | | Përcakton strukturën e strofës | Analizon strukturën e strofave në poezinë e dhënë | Malet me gurë, fusha me bar shumë, arat me grure, më tutje një lumë. Fshati për karshi me kish'e me varre, rrotull ca shtëpi të vogëla fare.. Strofat janë të shkruara në: a) strofë distik b) strofë tercina c) Strofë katrena | |
| | Poezia Soneti (tingëllima) | Identifikon sonetin te poezitë lirike | Njeh ndërtimin e vargjeve të saja | Prej sa vargjeve përbëhet soneti: a) 12 b) 16 c) 14 | |
| | | Dallon sonetin nga vargjet e rëndomta të poezisë | Njeh ndërtimin e strofave të sonetit | Prej sa vargjeve përbëhen dy strofat e para dhe prej sa vargjeve dy të fundit: a) 4/3 b) 2/2 | |

| | | | |
|---|--|---|---|
| Poezia Figurat stilistike: Onomatopea, krahasimi, metafora | REN: Identifikon figurat stilistike: Onomatopen, krahasimin, metaforën. | Në vargjet e dhëna njeh figurat stilistike: Onomatopen, krahasimin, metaforën. | Cila figurë stilistike është përdorur në fjalinë e mëposhtme: Bujari është gacë e mbulume. a) onomatopea b) krahasimi c) metafora |
| | Përdorë figurat stilistike | Shkruan varg duke përdorur figurat stilistike. | Shkruani një varg duke përdorur onomatope _____ |
| Proza Elementet e tekstit në prozë: fabula, tema, idea | REN: Identifikon nocionet: fabulë, temë, ide, si elementet e tekstit në prozë. | Jep përgjigjen e duhur në pyetje lidhur me fabulën, temën dhe idenë. | Tregimet e shkurtëra ku kafshët dhe bimët luajnë rolin e personazheve quhen: a) fabula b) tema c) idea |
| | Analizon tekste në prozë (gjenë temën, idenë, lokacionin, personazhet). | Analizon një tekst të shkurtër dhe të thjeshtë të tekstit në prozë. | Gjeje: temën, idenë, personazhet te fabula „Drenusha dhe pjergulla“ _____ _____ |
| Proza Proza popullore : legjenda, miti, traditat | REN: Identifikon tekste në prozë nga krijimtaria popullore | Vlerëson se cilat vepra bëjnë pjesë dhe janë karakteristike për prozën popullore | Në prozën popullore bëjnë pjesë: a) tregime, romane, novela b) miti, legjenda, traditat |
| | Interpreton vepra nga krijimtaria popullore | Përshkruan traditat, legjendën, mitin. | Tregoni një traditë që lidhet me vendlindjen tuaj: |
| Drama Llojet dramatike: tragjedia, komedia, drama bashkëkohore | REN: Identifikon ndarjen e dramës në: tragjedi, komedi, dramë bashkëkohore. | Në mënyrë të drejtë bën ndarjen e dramës në lloje dramatike. | Drama sipas zhanreve letrare ndahet në: a) lirike, epike dhe drame b) tragjedi, komedi, dramë bashkëkohore |
| | Përdorë fundin e dramës që ta karakterizoj llojin dramatik. | I karakterizon llojet dramatike sipas përfundimit të tyre. | Drama me fund të lumtur dhe me humor quhet: _____ |
| | Përcakton llojin dramatik sipas përmbajtjes të një teskti të njohur dramatik. | Dramën e dhënë e të njohur e klasifikon sipas llojit. | Drama: „Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr“ e Andon Zako Çajupi sipas llojit është: a) tragjedi b) komedi c) dramë bashkëkohore |

| Fusha | Tema/Përmbajta | Rezultate nga të nxënit për nivelin 4 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------------------------------|---|--|--|---|--------|
| TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA | Të shprehurit me shkrim dhe me gojë Përshkrim kronologjik dhe retrospektiv | REN: Identifikon përshkrimin kronologjik dhe retrospektiv. | Në një tekst të shkurtër e të thjeshtë proze tregon lloje të përshkrimit. | Për çfarë lloji përshkrimi bëhet fjalë në tregimin në vazhdim: Përnjëherë mu kujtuan çastet nga Viti i ri 2008. Të gjithë kishin arritur, ndërsa Arionën e kishte zënë një mot i ligë... a) kronologjik b) retrospektiv | 4 |
| | | Shfrytëzon përshkrim kronologjik dhe retrospektiv. | Përshkruan aspekte kronologjike dhe në retrospektiv. | Tregoni një ngjarje të shkurtër dhe të thjeshtë në mënyrë kronologjike _____ _____ _____ _____ | |
| | Të shprehurit me shkrim dhe me gojë Përshkrimi i pejsazhit, personalitetit, objektit, personazhit, | REN: Identifikon përshkrimin e pejsazhit, personazhit, personalitetit, objektit. | Në një tekst të shkurtër e të thjeshtë një përshkrimin e pejsazhit, personazhit, personalitetit, objektit. | -Çka është përshkruar në tregimin e mëposhtëm: Libri është në përgjithësi në gjendje të mirë . Faqet janë të zverdhura për shkak të kohës dhe është i shkruar me dorë. Lidhja e faqeve të librit është ende e qëndrueshme. a) peisazh b) personazh c) subjekt | |
| | | Në mënyrë të detajuar përshkruan pejsazhin, personazhin, personalitetin, objektin. | Detaisht përshkruan pejsazhin, personazhin, personalitetin, objektin. | Përshkruani personalitetin tuaj të preferuar nga jeta e përditsme _____ _____ | |
| | Të shprehurit me shkrim Njoftime, lajme | REN: Identifikon njoftime dhe lajme. | Në një tekst të shkurtër e të thjeshtë një njoftimet dhe lajmet. | -Çfarë lloj teksti është tregimi i mëposhtëm: Ministria e Bujqësisë, njofton të gjithë fermerët se afati për aplikim për subvencione për vitin 2018, është vazhduar deri më 13 prill 2018. a) njoftim b) lajm | |
| | | Shkruan njoftime dhe lajme. | Në temën e dhënë shkruan njoftime dhe lajme. | Shkruani një lajm për një ngjarje që ndodhi në kryeqytet, me rastin e maratonës së Shkupit të datës 25.05.2018. _____ _____ _____ | |

| Fusha | Tema/Përmbajta | Rezultate nga të nxënit për nivelin 4 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|------------------|---|--|---|---|--------|
| KULTURË E MEDIAS | Film Ndarja e filmit | REN: Identifikon filmin artistik, filmin e vizatuar dhe filmin dokumentar. | Drejtë përcakton llojin e një filmi të njohur. | „Tomi dhe Xheri ” është: a) film artistik b) film vizatimor c) film dokumentar | 4 |
| | | Bën dallimin e mënyrës së inçizimit të llojeve të ndryshme të filmave. | Drejtë përcakton mënyrat/kushtet e inçizimit të llojeve të ndryshme të filmave. | Personi teknik që bën xhirimin e ndonjë filmi apo programi tjetër me kamerë quhet_____. | |
| | Film Llojet e filmave sipas përmbajtjes | REN: Identifikon filmat artistik sipas përmbajtjes në: film familjar, erotik, lufte, kriminalistik, triler dhe film psikologjik. | Kualifikon si duhet një film të njohur sipas përmbajtjes. | Çfarë lloj filmi është filmi i famshëm „Troja” a) familjar b) psikologjik c) luftarak | |
| | Mediat e shkruara Pjesë e veprës së botuar | REN: Numëron pjesët që e përbëjnë një vepër të botuar. | I numëron pjesët e veprës së botuar. | Me cilat pjesë mund të përpilohet një vepër e botuar _____. | |
| | | E sqaron rolin e pjesëve të veprës së botuar (hyrja, parathënia, kaptina, vëllimi). | Njih rolin e pjesëve të veprës së botuar. | Në parathënie kuptojmë: a) për veprën dhe autorin b) për botuesin e veprës | |

| Fusha | Tema/Përmbajt-ja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|---|---|--|--------|
| GJUHË | Historia e gjuhës shqipe Kongresi i Alfabetit dhe i Drejtëshkrimit | REN: Identifikon periudhën kohore kur është bërë njësimi i gjuhës shqipe | Saktëson periudhën kohore të unifikimit të gjuhës shqipe | Ku dhe kur u mbajte Kongresi i Alfabetit të gjuhës shqipe? a) në vitin 1887 b) në vitin 1908 c) në vitin 1945 | 5 |
| | | E sqaron dukurin se në çka është bazuar gjuha shqipe | Njeh ndikim e gjuhës latine në njësimin e gjuhës shqipe | Alfabeti i gjuhës shqipe është bazuar në shkronjat: a) greke b) turke c) laatine | |
| | | Identifikon kohën dhe rrugën e gjatë e të vështirë të formimit e zhvillimit të gjuhës sonë letrare. | Njeh normat e vendosura në Kongresin e Drejtëshkrimit si dhe kohën dhe vendin e mbajtur të saj. | Ku dhe kur është mbajtur Kongresi i Drejtëshkrimit: a) në vitin 1972 - Tiranë b) në vitin 1974 - Prishtinë c) në vitin 1981 - Tetovë | |
| | Historia e gjuhës shqipe Rilindasit shqiptarë | REN: E sqaron zhvillimin e gjuhës shqipe gjatë kohës së Rilindjes Kombëtare të shek.XIX. | Njeh shkaqet kryesore të paraqitjes së Rilindjes Kombëtare | Paraqitja e Rilindjes Kombëtare shqiptare është: a) rezultat i lëvizjes politiko-shoqërore dhe kulturore për çlirimin e vendit nga pushtimet e huaja b) rezultat i shkrimeve të shumta | |
| | | I veçon rilindasit më të shquar në gjysmën e shek.XIX | I numëron përfaqësuesit kryesorë të Rilindjes Kombëtare | Përfaqësuesit kryesorë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare janë: : a) Sami Frashëri, Naum Veqilharxhi, Jeronim de Rada b) Haki Stërmilli, Sterjo Spasse, Ali Podrimja | |
| | | Thekson pikëpamjet për njësimin e gjuhës letrare. | Thekson qëndrimet e tyre për formimin e gjuhës letrare | Cili dialekt në masë të madhe është përfshirë në gjuhën e standardizuar? a) gegërishtja b) toskërishtja | |
| | Historia e gjuhës shqipe Abetarja dhe shkolla e parë shqipe | REN: E sqaron dukurinë e librave dhe shkollave të para. | E përmend abetaren e parë në gjuhën shqipe | Si quhet abetarja e parë në gjuhën shqipe dhe kush e shkroi? | |
| | | Njeh kohën dhe vendin e hapjes së parë të shkollës shqipe | Ka njohuri për mësonjëtorën e parë shqipe | Ku dhe në cilin vit u hap mësonjëtorja e parë shqipe? a) 7 mars 1887 b) 8 mars 1999 | |

| Fusha | Tema/Përmbajt-ja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|---|--|--|--------|
| | Fonetikë Theksi në fjali | Identifikon theksin e fjalisë | Në fjalinë e thjeshtë një se cilat fjalë shqiptohen me theks të njëjtë/përbashkët. | Theksi në fjali mund të jetë: a) proklitike dhe enklitike b) i drejtë dhe i zhdrejtë | |
| | | Identifikon theksin proklitik dhe enklitik | Një shembuj të thjeshtë të theksit proklitik dhe enklitik | Shkruaj një fjalë me theks proklitik dhe një me theks enklitik. _____, _____. | |
| | | Në mënyrë të drejtë shqipton/shkruan theksin e gjuhës shqipe | Në mënyrë të drejtë shqipton theksin në fjalinë e dhënë | Theksoje drejtë fjalën: Vera doli nga dhoma? | |
| | Morfologji Format e foljeve pavetore | REN: Identifikon format e foljeve pavetore - që tregon se nuk kanë kryefjalë dhe përdoren vetën në vetën e 3 njëjës | Në tekstin e shkurtë në prozë një format e foljeve pavetore | Fjalja Bie shi., është formë e foljes: a) vetore b) pavetore | |
| | | Përdorë format e foljeve pavetore që të shënoj dukuri natyrore dhe gjendje shpirtërore | Transformon drejtë format e foljeve vetore në ato pavetore | Foljen laj nga forma veprare ktheje në formën joveprare (pavetore): | |
| | | | | | |

| Fusha | Tema/Përmbajt-ja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|--|---|---|--|--|--------|
| | Morfologji Format e shtjelluara të foljes: -koha e tashme koha e shkuar Format e thjeshta foljore: -Koha e tashme, -Koha e kryer e thjeshtë dhe e pakryera -Mënyra urdhërore | REN:Identifikon format e thjeshta foljor si forma që përbëhen vetëm nga një fjalë | Në fjalinë e thjeshtë bën dallimin mes formës foljore të thjeshtë dhe asaj të përbërë | Fryn erë. Në fjalinë e thjeshtë, forma foljore e thjeshtë është: a) fryn b) erë | |
| | | Në mënyrë të drejtë përdorë kohën e tashme | Gjatë të shkruarit të fjalisë së thjeshtë në mënyrë të drejtë përdorë prapashtesat për kohën e tashme:-j,-n,-n,-më,-ni,-jn | Shkruani një fjali me foljen shkoj në kohën e tashme: _____. | |
| | | Në mënyrë të drejtë përdorë kohën e kryer të thjeshtë dhe të pakryerën. | Gjatë të shkruarit të fjalisë së thjeshtë në mënyrë të drejtë përdorë prapashtesat për format e thjeshta foljore. | Shkruani nga një fjali me foljen mësoj në të kryerën e thjeshtë dhe të pakryerën: _____ _____. | |
| | | Në mënyrë të drejtë mënyrën urdhërore | Gjatë të shkruarit të fjalisë së thjeshtë në mënyrë të drejtë përdorë format e mënyrës urdhërore: për v.2. nj. për v.2.sh. | Shkruani një fjali me foljen punoj në mënyrën urdhërore: _____. | |
| Morfologji Ndajfoljet (definicioni) Llojet e ndajfoljeve | REN:Identifikon ndajfoljet si fjalë të pandryshueshme të cilat e plotësojnë foljen | Në fjalinë e dhënë njih ndajfoljen si lloj fjale e pandryshueshme | Erdha sot. Në fjalinë e mëposhtme ndajfolje është: a) erdha b) sot | | |
| | Në mënyrë të drejtë i përdorë ndajfoljet e kohës, mënyrës dhe sasisë. | Në fjalinë e dhënë foljen e plotëson me ndajfolje kohe, vendi, mënyre, sasië. | E njoh mirë Butrintit sepse e kam vizituar tri herë. Në fjalinë e lartëpërmendur gjeje ndajfoljen e sasisë._____ | | |

| Fusha | Tema/Përmbajt-ja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|---|---|--|--|--|--------|
| | Morfologji Ndajfoljet | REN:Identifikon ndajfoljet si fjalë të shkurtëra të pandryshueshme me anë të cilave tregohet marrëdhënie të ndryshme në fjali. | Në fjalinë e dhënë një ndajfoljen, si fjalë e pandryshueshme, me anë të së cilës tregohen marrëdhënie të ndryshme në fjali. | Irena shkruan qartë, bukur dhe saktë? Në fjalinë e mëposhtme ndajfolje është: a) Irena b) shkruan c) qartë, bukur, saktë | |
| | | Në mënyrë të drejtë i përdorë ndajfoljet. | Fjalinë e dhënë e plotëson me ndajfolje përkatëse. | Fjalinë e mëposhtme plotësoe me ndajfolje përkatëse: Ata u ngritën shumë _____ atë ditë. | |
| | Morfologji Lidhëzat (definicioni), Ndarja e lidhëzave | REN:Identifikon lidhëzat si fjalë të pandryshueshme të cilat lidhin fjalët në fjali dhe fjalitë mes vete në fjalitë e përbëra. | Në fjalinë e dhënë një lidhëzat si fjalë të pandryshueshme të cilat lidhin fjalët në fjali. | Unë kam blerë buk dhe qumësht. në fjalinë e lartëpërmendur lidhëz është: a) kam b) dhe c) blerë | |
| | | Në mënyrë të drejtë përdorë lidhëzat për t'i lidhur gjymtyrët/fjalitë në fjalinë e përbërë. | Në mënyrë të drejtë lidh disa gjymtyrë/fjali në përbërje të një fjalie të përbërë. | Plotëso fjalinë me lidhëza përkatëse që e njejta të jetë e kuptueshme dhe logjike. Isha në ambulancë _____ atje më shkruan tableta antibiotik _____ kisha dhimbje fyti. | |
| | Sintaksë Ndarja e fjalisë së përbërë: me lidhëza dhe pa to | REN:Identifikon fjali të formuara me lidhëza dhe pa to. | Fjalinë e përbërë, në bazë të përdorimit të lidhëzave, e vlerëson se në cilin grup bën pjesë. | Dielli u fsheh, qielli u nxi. Fjalja sipas përdorimit të lidhëzave është: a) fjali me lidhëza b) fjali pa lidhëza | |
| | | Në mënyrë të drejtë transformon fjalitë me lidhëza duke ia hequr të njejtat dhe anasjelltas. | Saktë shton lidhëza përkatëse në fjali dhe të njejtat i largon. | Dielli u fsheh, qielli u nxi. Fjalja është e formuar pa lidhëza, të njejtën transformo në fjali me lidhëza përkatëse _____. | |
| Sintaksë Ndarja e fjalëve të përbëra me nënrenditje dhe bashkërenditje | REN: Bën ndarjen e fjalisë së përbërë, bazuar në marrëdhënien gjymtyrë/fjali në të, në fjali me bashkërenditje dhe nënrenditje. | Bën vlerësim të saktë dhe të drejtë për marrëdhëniet e ndërsjellta të gjymtyrës/fjalisë në kuadër të fjalisë së përbërë. | Nuk luajtën mirë dhe ranë një rang më poshtë. Fjalja e lartëpërmendur është: a) fjali me bashkërenditje b) fjali me nënrenditje | | |

| Fusha | Tema/Përmbajt-ja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|---|--|---|--------|
| | Sintaksë Fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërshtore | REN: Në mënyrë të drejtë përdorë fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërshtore. | Fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërshtore lidh me lidhëzat:kurse, mirëpo,megjithatë | Nënvizo lidhëzën përkatëse te fjalia e mëposhtme me bashkërenditje kundërshtore: Dy shoqet e saja e ndoqën, ndërsa meshkujt qëndruan prapa. | |
| | Sintaksë Fjalitë e përbëra me bashkërenditje veçuese | REN: Në mënyrë të drejtë përdorë fjalitë e përbëra me bashkërenditje veçuese. | Fjalitë e përbëra me bashkërenditje veçuese lidh me lidhëzat: ose, apo, ose...ose | Nënvizo lidhëzën përkatëse te fjalia e mëposhtme me bashkërenditje veçuese: Ja i arrijmë shokët, ja plasim. | |
| | Sintaksë Fjalitë e përbëra me bashkërenditje shtuese | REN: Në mënyrë të drejtë përdorë fjalitë e përbëra me bashkërenditje shtuese. | Fjalitë e përbëra me bashkërenditje shtuese lidhen me lidhëzat:dhe, edhe, as...as..., jo vetëm..., por edhe... | Nënvizo lidhëzën përkatëse te fjalia e mëposhtme me bashkërenditje shtuese: As pushk nuk dëgjoheshin, as flakë nuk shiheshin më. | |
| | Sintaksë Fjalitë e përbëra me bashkërenditje përmbyllëse | REN: Në mënyrë të drejtë përdorë fjalitë e përbëra me bashkërenditje përmbyllëse. | Fjalitë e përbëra me bashkërenditje përmbyllëse lidhen me lidhëzat: andaj, pra, prandaj | Nënvizo lidhëzën përkatëse te fjalia e mëposhtme me bashkërenditje përmbyllëse: Vera kishte ditëlindjen, prandaj i ftoi të gjithë shokët dhe shoqet. | |
| | Drejtëshkrimi Shkrimi i datave | REN:Në mënyrë të drejtë shkruan data me: -numra arab (2.8.1903) -numra romak (8.IX 1991) dhe -me shkronja (15 shtator 1991) | I zbaton rregullat drejtëshkrimore gjatë të shkruarit e datave | Cilat nga datat e mëposhtme është e shkruar drejtë: a) në vitin 2.8.1903 . b) në vitin 2.VIII. 1903 . | |
| | Fjalori dhe stili Fjalori i gjuhës shqipe sipas prejardhjes së fjalëve | REN:Identifikon fjalët sipas prejardhjes së tyre (fjalë vendore dhe të huaj) | Ndërlidh fjalët e dhëna sipas prejardhjes së tyre | Sipas prejardhjes së tyre në cilën grup bëjnë pjesë fjalët e mëposhtme: bashkëbisedim neologjizëm isto ndërkombëtarizma qebap barbarizëm ok turqizëm | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|---------|---|--|--|---|--------|
| LETËRSI | Poezi Poezia sociale | REN: Identifikon poezinë sociale si poezi ku këndohet padrejtësia shoqërore ndaj punëtorëve | Lidh motivin e këngës me llojin e poezisë lirike | Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi, kafshatë që të mbetë në fyt edhe të ze trishtimi kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin të tanë jetën e vet derisa të vdesin. Sipas motivit poezia .. Poema e mjerimit " nga Migjeni është: a) poezi sociale b) poezi e dashurisë c) poezi patriotike | 5 |
| | | Analizon poezinë sociale | Gjen motivin në poezinë sociale. |Mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme; asht e neveritshme, e keqe, e turpshme; balli që e ka, syt që e shprehin, buzët që më kot mundohen ta mshefin - janë fëmitë e padijes e flitë e përbuzjes, të mbetunat e flliqta rreth e përqark tryezës mbi të cilën hangri darkën një qen e pamshirshëm me bark shekulluer, gjithmon i pangishëm. Në poezinë sociale „Poema e mejrimit " shkrimtari është motivuar nga : a) dhimbja e klasës punëtore b) dhimbja e fshatarëve | |
| | Poezi Elegji | REN: Identifikon elegjinë si lloj i këngës epiko-lirike ku i këndohet disponimit dhe ndjenjave pikëlluese. | Ndërlidh motivin me llojin e këngëve epiko-lirike. | Në elegji, si motiv mund të jetë: a) humbja e një të afërmi b) dashuria ndaj atdheut c) dashuria ndaj të dashurës/dashurit | |
| | Poezi Llojet e krijimeve epiko-lirike Romansa Balada | REN: Identifikon veçoritë e krijimeve epiko-lirike. | Përcakton veçoritë e këngëve epiko-lirike. | Këngët që përmbajnë elemente epike dhe lirike quhen: a) këngë lirike b) këngë epike c) këngë epiko-lirike | |
| | | Identifikon baladën si lloj epiko-lirik me përfundim pikëllues. | Përmendë karakteristikat e baladës. | Balada është një këngë lirike-epike: a) ku përshkruhet ndonjë dashuri që përfundon hareshëm. b) ku përshkruhet ndonjë dashuri që përfundon me pikëllim. | |
| | | Identifikon romansën si lloj epiko-lirike me përfundim të lumtur. | Përmendë karakteristikat e romansës. | Romansa është një lloj vjershe liriko- epike: a) ku përshkruhet ndonjë dashuri që përfundon hareshëm. b) ku përshkruhet ndonjë dashuri që përfundon me pikëllim. | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|--|--|---|--------|
| | Poezi Figurat stilistike: Refreni Gradacioni Apostrofa Hiperbola | REN: Identifikon figurat stilistike refrenin, gradacionin, apostrofën dhe hiperbolën. | Në mënyrë të drejtë ndërlidh figurat stilistike me veçoritë e tyre. | Lidhi figurat stilistike me karakteristikat e njohura të tyre: refreni - përsëritja e vargjeve apo strofave të njëjta gradacioni - të drejtuarit ndaj dikujt ose diçkaje apostrofi - egzagjërimi i karakteristikave dhe ngjarjeve hiperbola - përforcimi gradual i emocioneve | |
| | | Analizon përdorimin e figurave stilistike: refrenin, gradacionin, apostrofën dhe hiperbolën. | Në vargjet e njohura njih shembull mbresëlënës të figurës stilistike. | “Ne mur, përsipër vatrës, varej një shpate e kohërave të vjetra që s’e ngre dot njeriu i sotëm as me dy duar. Qe palla e Kastrioteve, e mbajtur brez pas brezi prej trimash qe nxori ajo dere e shkëlqyer. Turqit shkelën dhe plaçkitën kështjellën, por pallën s’e nganë, se asnjë s’që i zoti ta përdorte... Në tekstin e lartëpërmendur, cila figurë stilistike është përdorur: a) refreni b) gradacioni c) apostrofi d) hiperbola | |
| | Prozë Romani (definicioni) | REN: Bën dallimin mes tregimit si vepër e shkurtër në prozë dhe romanit si vepër më e madhe epike. | Përcakton karakteristikat e romanit. | Roman : a) është vepër e shkurtër letrare e gjinisë epike . b) është vepër e gjatë letrare e gjinisë epike , e shkruar ne prozë që pasqyron një rreth të gjërë ngjarjesh e dukurish nga jeta shoqërore | |
| | | I njeh romancierët më të njohur shqiptarë. | Përmendë romancierët më të njohur në letërsinë shqiptare. | Trego cilët janë romancierët më të njohur shqiptarë? | |
| | | Interpreton romanin e lexuar . | Specifikon kohën, vendin, temën, përmbajtjen dhe personazhet në një roman të lexuar sipas zgjedhjes. | Përcakto: kohën, vendin, temën, përmbajtjen, personazhet nga një roman që ke lexuar. | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|--|--|--|--------|
| | Llojet shkencore-letrare Ditari Biografia, Autobiografia | REN: Bën dallimin mes llojeve shkencoro-letrare: ditari, biografia dhe autobiografia. | Në mënyrë të drejtë i specifikon karakteristikat e ditarit, biografisë dhe autobiografisë. | Si quhet Fletorja me shenime të rëndësishme të ditës dhe me data të shkruara? | |
| | | Identifikon llojet e teskteve shkencoro-letrare. | Në tekstin e dhënë njih karakteristikat e ditarit, biografisë dhe autobiografisë. | ...7 janar 1944 doja me shkruaj një roman mbi jetën e shoqeve e të shoqëve. Por s,kam as leter, as laps, as edhe kurgja.lapsin e vogelqe me ka mbete,e perodr me kursim.... Teksti i lartëpërmendur është: a) ditar b) biografi c) autobiografi | |
| | | Shkruan autobiografi të shkurtër. | Aplikon njohuri gjatë të shkruarit e tekstit autobiografik. | Shkruaj një autobiografi të shkurtër _____ _____ _____ _____ | |
| | Drama Tregim i personazhit | REN: Identifikon personazhe nëpërmjet deklaratës së personazhit, si karakteristikë e tekstit dramatik. | Specifikon personazhe si bartës të veprimit dramatik në tekstin e dramës. | TANA Ç'bën ashtu, moj Kote? KOTE S' është puna jote. TANA Moj, mos je e marrë? Kam ardhë më parë. KOTE S'mund të rri këtu, Kam të tjera punë po hiq nga unë! Nga pjesa e shkëputur e dramës kemi: a) 2 personazhe dhe 4 replika b) 4 personazhe dhe 2 replika | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---------------------------|--|--|--|--------|
| | Drama Dialogu-monologu | REN: Identifikon forma shprehëse në fjalimin e personazheve - dialog dhe monolog . | Në deklaratën e personazheve, njeh dialogun dhe monologun. | ARTANI: Ja, shiko Zana. Ky është kopshti im. Ka shumë lule të bukura. Po kopshti yt, si është? ZANA: Edhe kopshti im është i bukur. Forma e të shprehurit që është përdorur në tekst është: a) dialog b) monolog | |
| | | Shkruan dialog dhe monolog. | Shkruan tekst të shkurtër ku kemi monolog dhe dialog. | Shkruaj një dialog të shkurtër . _____ _____ | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------------------------------|-------------------------------------|--|--|--|--------|
| TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA | Të shprehurit me gojë Te folurit | REN: Identifikon fjalimin të drejtuar para të pranishmive në ndonjë ngjarje. | Në deklaratën e dhënë njeh elementet e të folurit-të drejtuarit para të pranishmive. | Të nderuar mysafirë, të dashur nxënës të Shkollës fillore si dhe shumë të respektuar stafi i ShFK " Naim Frashëri ", në emrin tim si drejtor i shkollës së bashku me stafin udhëheqës, dëshiroj që me rastin e festës së shkollës tonë e cila është për ne dita e shkollës, është një privilegj dhe kënaqësi e vçant t`ju përshëndes dhe t`ju uroj mirëseardhje... Tregimi paraqet: a) monolog b) fjalim c) dialog | 5 |
| | | Shkruan fjalim. | Shkruan fjalim të thjeshtë me rastin e ndonjë ngjarje. | Shkruani një fjalim me rastin e hapjes së një fabrike të re për përpunimin e drurit. | |
| | Të shprehurit me shkrim Ese | REN: Identifikon karakteristika të esesë, si lloj i kritikës letrare. | Saktë përcakton karakteristikat e esesë. | Artikulli i gjatë i studimit me karakter kritik ose publicistik, i cili trajton në mënyrë të përgjithshme çështjet shoqërore, shkencore, letrare është: a) dramë b) ditar c) ese | |
| | | Dallon një ese nga krijimet tjera. | Në tesktin e dhënë njeh elementet e esesë. | "Udhëtim Imagjinar në Kohë" Jam duke udhëtuar me imagjinatën time në një vend të ngjashëm po krejt ndryshe vendit ku jetoj.Jam duke shkuar në një botë tjetër,jo të ngjashme nga planeti tokë. Po shkoj me një shpejtësi shumë të madhe që dhe më fut frikën, por imagjinata ime smë lejon të kem frikë. ... Teksti paraqet: a) ese b) fjalim c) dramë | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|---|---|---|---|--------|
| | Tekste me dedikim praktik Ankesë/Lutje | REN: Identifikon tekste për qëllime praktike. | Në mënyrë të drejtë përcakton karakteristikat e ankesës/lutjes | Teksti me anë të së cilës parashtrohet një ankesë deri te ndonjë institucion quhet: a) ankesë b) lutje | |
| | | Aplikon tekste për qëllime praktike. | Në mënyrë të drejtë, shkruan lutje me gjitha informatat e grumbulluara për ju si parashtrues. | Shkruani një LUTJE deri te komuna juaj: | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 5 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|------------------|---|---|---|--|--------|
| KULTURË E MEDIAS | Filmi Krijimi i filmit nga idea deri në skenar | REN: Identifikon fazat gjatë inçizimit të filmit. | Njeh iden e filmit, sinopsisin, skenarin, librin e inçizimit. | Skenar është: a) Idea fillestare për inçizimin e filmit b) projekt plani i inçizimit të filmit c) baza e inçizimit të filmit d) përshkrim detaj i gjitha elementeve që e përbëjnë filmin | 5 |
| | | Njeh procesin e krijimit të një filmi. | Njeh rolin e gjithë aktorëve në film. | Një person që shndërron tekstin e shkruar në të folur, e që luan një rol quhet: a) kaskader b) akrobat c) artist | |
| | | Interpreton përmbajtjen e filmit. | Në mënyrë të thjeshtë spjegon përmbajtjen e filmit. | Tregoni përmbajtjen e filmit tuaj të preferuar në mënyrë të thjeshtë | |
| | | Komenton personazhet e filmit. | Jep qëndrimin e tij për veprimin e personazheve | Cili personazh në film ju zhgënjën me veprimin / vendimin e tij? | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|--|--|--|---|--------|
| GJUHË | Zhvillimi i gjuhës shqipe Letërsia bashkohore shqiptare | REN: Identifikon shkrimtarët e letërsisë bashkohore shqiptare | Përmendë shkrimtarët më të njohur të letërsisë bashkohore shqiptare | Cilët shkrimtarë i takojnë Letërsisë bashkohore shqiptare: a) Ismail Kadare, Jakov Xoxa, Dritëro Agolli b) Naim Frashëri, Pashko Vasa, Naum Veqilharxhi | 6 |
| | | E kupton rëndësin historike të veprave të shkrimtarëve pas Luftës së Dytë Botërore | Njih temën që mbizotron në veprat e shkrimtarëve të Letërsisë bashkohore shqiptare | Cila temë mbizotron në veprat e shkrimtarëve të Letërsisë bashkohore shqiptare: a) liria e fituar nga Lufta nacional-çlirimtare b) tema e dashurisë | |
| | | I numëron veprat më të njohura të shkrimtarëve nga Letërsia bashkohore shqiptare | Përmendë romanet më të njohura të shkrimtarëve nga Letërsia bashkohore shqiptare | Romani më i njohur i Ismail Kadaresë është: a) "Lumi i vdekur" b) "Gjenarali i ushtrisë së vdekur" | |
| | Zhvillimi i gjuhës shqipe Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe | REN: Identifikon periudhat e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe | Sqaron periudhat e ndryshme të zhvillimit të gjuhës shqipe | Cilat janë periudhat e zhvillimit të gjuhës shqipe: a) parakombëtare dhe kombëtare b) historike dhe fetare | |
| | | E njeh rëndësin historike të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe | Përmendë etapat e periudhës kombëtare të gjuhës letrare shqipe | Në sa etapa ndahet periudha kombëtare shqipe: a) 2 etapa b) 3 etapa | |
| | | Sqaron etapat e ndryshme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe | Saktë dhe në mënyrë kronologjike ndan etapat e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe | Kur fillon etapa e tretë e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe: a) nga viti 1944 e gjer më sot b) nga viti 1999 | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|---|--|--|---|--|--------|
| | <p>Morfologji</p> <p>Fojlet e përbëra foljore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - E kryera - Më se e kryera - E kryera e tejkshuar - E ardhmja e përparme -folja ndihmëse jam -folja ndihmëse kam -Mënyra dëshirore | REN: Identifikon forma të përbëra foljore si forma të përbëra nga dy a më shumë fjalë. | Në fjalinë e thjeshtë bën dallimin mes formës së thjeshtë dhe formës së përbërë foljore. | Po shpejtoj, së shpejti do të arrij. Në fjali, forma e përbërë foljorë është: a) po shpejtoj b) do të arrij | |
| | | Identifikon forma të kohës së kryer | Në fjalinë e thjeshtë njeh format e kohës së kryer. | Në cilën fjali është përdorur forma për kohën e kryer: a) Kam mësuar. b) Kisha ardhur me kohë, por me zuri shiu. | |
| | Drejtë përdorë kohën më se të kryer me ndihmën e foljeve ndihmëse. | Gjatë të shkruarit të fjalisë së thjeshtë, i përdorë drejtë format për më se të kryerën. | Shkruaj fjali me foljen shkoj në kohën më se të kryer: _____. | | |
| | Identifikon forma për kohën e ardhme | Në fjalinë e thjeshtë njeh format e kohës së ardhme të përparme | Në cilën fjali është përdorur forma për kohën e ardhme të përparme: a) Kur do të ktheheni ju, unë do ti kem mbaruar detyrat. b) Do shkojm atje. | | |
| | Drejtë përdorë kohën e ardhme të përparme të formuar nga pjesëza do dhe foljen në kohën e tashme | Gjatë të shkruarit të fjalisë së thjeshtë përdorë drejtë format për kohën e ardhme | Shkruaj fjali me foljen shikoj në kohën e ardhme të përparme _____. | | |
| | Identifikon format e foljes ndihmëse jam | Në fjalinë e thjeshtë njeh foljen ndihmëse jam | Në cilën fjali është përdorur folja ndihmëse jam: a) Arta është zgjuar para meje. b) Arta zgjohet para meje. | | |
| | Drejtë përdorë foljen ndihmëse jam dhe mbiemrin prejfoljor | Gjatë të shkruarit të fjalisë së thjeshtë, përdorë drejtë foljen ndihmëse jam | Shkruaj fjali me foljen shkoj dhe foljen ndihmëse jam: _____ | | |
| | Identifikon format e foljes ndihmëse kam | Në fjalinë e thjeshtë njeh foljen ndihmëse kam | Në cilën fjali është përdorur folja ndihmëse kam: a) Unë kisha ardhur para jush. b) Erdha para jush. | | |
| | Drejtë përdorë foljen ndihmëse kam | Gjatë të shkruarit të fjalisë së thjeshtë, përdorë drejtë foljen ndihmëse kam | Shkruaj fjali me foljen vizatoj dhe foljen ndihmëse kam: _____ | | |
| | Identifikon forma të mënyrës dëshirore | Në fjalinë e thjeshtë njeh format e mënyrës dëshirore | Në cilën fjali kemi prezente mënyrën dëshirore? a) Erdha më herët. b) U bëfsh njëqind vjeç! | | |
| Në mënyrë të drejtë përdorë mënyrën dëshirore | Gjatë të shkruarit të fjalisë së thjeshtë përdorë drejtë format për mënyrën dëshirore | Shkruaj fjali të mënyrës dëshirore me foljen rroj: _____ _____ | | | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|-----------------------------|--|--|--|--------|
| | Morfologji Pjesëza | REN: Identifikon pjesëzat, si fjalë të pandryshueshme, të cilat theksojnë kuptimin e fjalëve të tjera në fjali, shkallëzojnë mbiemra etj. | Në fjalinë e dhënë i njeh pjesëzat si fjalë të pandryshueshme | Ja erdhi Viti i Ri. Në fjalinë e dhënë cila fjalë është pjesëz: a) erdhi b) Ja c) Viti i Ri | |
| | | Në mënyrë të drejtë përdorë pjesëza për të theksuar kuptimin e fjalëve të tjera në fjali, të shkallëzojë mbiemra etj. | Në fjalinë e thjeshtë, në mënyrë të drejtë përdorë pjesëza për të theksuar kuptimin e fjalëve të tjera në fjali, të shkallëzojë mbiemra etj. | Plotësoje fjalinë duke i shtuar pjesëzën përkatëse: Ai ____ lexonte librin. | |
| | Morfologji Pasthirrma | REN: Identifikon pasthirrmat si fjalë të pandryshueshme të cilat përdoren për të shprehur ndjenja, emitim të tingujve dhe tërheqje të vëmendjes. | Në fjalinë e dhënë i njeh pasthirrmat si fjalë të pandryshueshme. | Ua! Paske ardhur! Në fjalinë e dhënë cila fjalë është pasthirrmë: a) Ua b) paske c) ardhur | |
| | | Në mënyrë të drejtë përdorë pasthirrma për të shprehur ndjenja, emitim të tingujve dhe tërheqje të vëmendjes. | Në fjalinë e thjeshtë, në mënyrë të drejtë përdorë pasthirrma për të shprehur ndjenja, emitim të tingujve dhe tërheqje vëmendjes. | Plotësoje fjalinë duke ia shtuar pasthirrmën që i përshtatet: o, ore, hop, aha. _____, sa mirë që erdhët! | |
| | Morfologji Fjalët modale | REN: Identifikon fjalët modale si fjalë e pandryshueshme të cilat shprehin ndjenja, emitim të tingujve dhe tërheqje vëmendjes. | Në fjalinë e dhënë njeh fjalët modale si fjalë të pandryshueshme. | Mund të vij. Në fjalinë e dhënë fjala modale është: a) mund b) të c) vij | |
| | | Në mënyrë të drejtë i përdorë fjalët modale të cilat shprehin bindje, supozim dhe pohim. | Në fjalinë e thjeshtë, në mënyrë të drejtë i përdorë fjalët modale të cilat shprehin bindje, supozim dhe pohim. | Plotëso fjalinë me fjalë modale duke shprehur bindje: _____ patjetër të shkojmë në shkollë. | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|---|---|--|--|--|--------|
| Sintaksë Fjali me nënrenditje: -ftilluese -vendore -kohore -shkakore -qëllimore - krahasore -mënyrore -kushtore - rrjedhimore | | REN: Identifikon lloje të fjalive me nënrenditje. | Në tekst të shkurtër njih lloje të fjalive me nënrenditje . | Agroni ecte në mënyrë të çuditshme. Në fjalinë e lartëpërmendur, për çfarë lloji të fjalisë me nënrenditje bëhet fjalë: a) shkakore b) mënyrore c) qëllimore d) rrjedhimore | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura kohore. | Gjymtyrat/fjalitë i ndërlidh me lidhëza kohore: kur, sa, si, derisa, kurdoqë. | Formo fjali të nënrenditur kohore duke shtuar lidhëzat përkatëse: _____dolëm nga kinemaja qielli ishte mbushur me yje. | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura vendore. | Gjymtyrat/fjalitë i lidh me lidhëza vendore: nga, ku, kudo, deri ku, posa që. | Formo fjali të nënrenditur vendore duke shtuar lidhëzat përkatëse: _____dhemb dhëmbi vete gjuha | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura shkakore. | Gjymtyrat/fjalitë i lidh me lidhëza shkakore: sepse, pasi, derisa, ngase, për arsye se. | Formo fjali të nënrenditur shkakore duke shtuar lidhëzat përkatëse: Agroni ecte me kujdes_____frigohej nga fryma e madhe | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura rrjedhimore. | Gjymtyrat/fjalitë i lidh me lidhëza rrjedhimore: saqë, aq sa, kështu që. | Formo fjali të nënrenditur rrjedhimore duke shtuar lidhëzat përkatëse: Fëmijët vrapuan,_____u rrëzuan. | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura kushtore. | Gjymtyrat/fjalitë i lidh me lidhëza kushtore: në, nëse, në qoftë se, sikur, po qe se, me kusht që. | Formo fjali të nënrenditur kushtore duke shtuar lidhëzat përkatëse: Unë luaj _____kam kohë të lirë. | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura lejore. | Gjymtyrat/fjalitë i lidh me lidhëza lejore: megjithëse, ndonëse, edhe sikur, edhe pse. | Formo fjali të nënrenditur lejore duke shtuar lidhëzat përkatëse: Nxënësit shkojnë në shkollë _____bie shi. | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura ftilluese. | Gjymtyrat/fjalitë i lidh me lidhëza ftilluese: se, nëse, në. | Formo fjali të nënrenditur ftilluese duke shtuar lidhëzat përkatëse: Unë ha mollen _____është e tharrtë. | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura mënyrore. | Gjymtyrat/fjalitë i lidh me lidhëza mënyrore: si, siç, ashtu si, sikurse. | Formo fjali të nënrenditur mënyrore duke shtuar lidhëzat përkatëse: Motra palosi rrobat_____nëna. | |
| | | Përdorë drejtë fjalitë e nënrenditura qëllimore. | Gjymtyrat/fjalitë i lidh me lidhëza qëllimore: që, me qëllim që, në mënyrë që. | Formo fjali të nënrenditur qëllimore duke shtuar lidhëzat përkatëse Unë u futa në banjo, _____që të pastrohem. | |
| | Fjalori dhe stili Stilet funksionale: Administrativ Shkencor Gazetaresk Letrar | Identifikon stile/mënyra të ndryshme të të shprehurit. | Në tekst të thjeshtë njih stilet funksionale. | Sipas mënyrës së shprehjes sa stile funksionale dallojmë: a) 2 b) 4 c) 6 d) 8 | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|--------|--|--|---|---|--------|
| LETËRI | Poezi Poema | REN: Identifikon poemën si këngë të gjatë epiko-lirike në të cilën ka ngjarje, personazhe dhe shumë ndjenja. | Në mënyrë të drejtë i përcakton karakteristikat e poemës. | Poema: a) është një vjershë me elemente lirike dhe epike, por me përmasa të mëdha b) është një vjershë e shkurtër epiko- lirike me përmbajtje të dashurisë | 6 |
| | | E kupton zhvillimin historik të llojit të poemës epiko-lirike në gjuhën shqipe. | Shënon poemën më të njohur dhe krijuesin e saj nga shek.XIX. | Cila nga shembujt e mëposhtme është poemë: a) „Këngët e Milosaos“ nga Jeronim de Rada b) „Bagëti e bujqësi“ Naim Frashëri | |
| | Poezi Rima: E puthur E mbyllur E kryqëzuar | REN: Identifikon llojet e rimave sipas fjalëve të rihuara në vargje dhe strofë. | Në mënyrë të drejtë i përcakton karakteristikat e rimës së puthur, mbyllur dhe kryqëzuar. | Kur strofa është e përbërë nga katër vargje (strofe katrene) dhe kur vargu i parë me vargun e dytë dhe vargu i tretë me vargun e katërt rimohen atëherë behët fjalë për: a) rimë të puthur b) rimë të mbyllur c) rimë të kryqëzuar | |
| | | Njeh fjalë të rihuara në vargje dhe emërton llojin e rimës. | Tregon llojin e rimës sipas vargjeve të rihuara në strofë. | „Malet me gurë, fusha me bar shumë, arat me grurë, më tutje një lumë..“ Rima në strofën e lartëpërmendur sipas vargjeve të rihuara është: a) rimë e puthur b) rimë e mbyllur c) rimë e kryqëzuar | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|--|---|--|---|--------|
| | Poezia Figurat stilistike: Alegoria antiteza Ironia Simboli | Sqaron se çka arrihet me përdorimin e figurave stilistike në veprat letrare. | Njih vizualitet, muzikalitet dhe emocione gjatë përdorimit të figurave stilistike. | Figurat stilistike kontribojnë që krijimtaria letrare të jetë: a) më konkrete, më e qartë, më e kuptueshme b) vizuale, shprehëse dhe emocionale | |
| | | REN: Identifikon figura stilistike: alegorin, ironin, simbolin, antitezën. | Si duhet lidh figura stilistike me veçoritë e tyre. | Lidh figurat stilistike me karakteristikat e tyre të njohura: Alegoria - figurë artistike që personifikon me forcë më të madhe tiparet më karakteristike të një dukurie. Antiteza - tallje me mangësit e njerëzve. Ironia - përafrimi i dy antonimeve, dy dukurive të kundërta, dy pamjeve. Simboli - metaforë e zgjeruar | |
| | | Analizon përdorimin e figurave stilistike: alegorin, ironin, simbolin, antitezën. | Në vargjet e njohura njih shembull mbresëlënës të një figure stilistike. | „Bilbili i vorfën” Po shkrihet bora Dimni po shkon; Bylbyl i vorfen Pse po gjëmon ? Pushoj murrllani Me duhie t`vet : Bylbyl i vorfen , Çou , mos rri shkret. . .” Te “Bilbili i vorfën” cila figurë stilistike është përdorur? a) alegoria b) antiteza c) ironia d) simboli | |
| | | Përdorë figura stilistike në krijimin letrar si dhe në komunikimin e përditshëm. | Shkruan fjali të thjeshtë me dozë talljeje ndaj dikujt apo diçkaje. | Shkruani një fjali në të cilën do të përdorni figurën stilistike-ironin: | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|--------------------------------|--|--|--|---|--------|
| | Proza Roman: -fantastiko -shkencor -historik -shoqëror | REN: Identifikon llojet e romaneve sipas temës së përpunuar. | Lidh si duhet llojet e romaneve sipas karakteristikave të tyre. | Lidh llojet e romaneve sipas përshkrimit që ekziston:shoqëror -paraqet personazhe historike dhe te trilluar fantastiko-shoqërorë - pasqyron jetën në mënyrë jo të zakonshme historik -gërshetohen elemntet realiste me ato fantastike dhe shkencore | |
| | | Spjegon përmbajtjen e romanit të lexuar. | Në mënyrë të thjeshtë spjegon përmbajtjen e romanit. | Përshkruani në mënyrë të thjeshtë përmbajtjen e romanit tuaj të preferuar. | |
| | | Analizon personazhe të romaneve. | Jep qëndrimin e tij për veprimet e personazheve. | Sipas mendimit tuaj, cili personazh në roman është personazh pozitiv dhe cili negativ? | |
| | | Përmend shembuj nga romanet e lexuara nga zhanri shoqëror, fantstiko-shkencor dhe historik. | Përmendë shembuj nga romanet e lexuara sipas zhanrit. | Jepni një shembull të një romani të lexuar- historik: | |
| | Drama (klasike) Përbërja e tekstit dramatik: ekspozicioni, thurja, pika kulmore, peripecia dhe zgjidhja | REN: Identifikon fazat e zhvillimit të veprimit dramatik | Di se si duhet lidhur fazat e zhvillimit të veprimit dramatik sipas karakteristikave të tyre. | Lidhi përbërsit e tekstit dramatik me definicionet përkatëse: Ekspozicioni - zgjidhja e konfliktit Thurje - kulmi i përplasjes Pika Kulmore - fillimi i konfliktit Peripecia - faza fillestare Zgjidhja - konflikt i zgjidhur | |
| Drama Akti, pamja dhe skena | Analizon konflikt mes personazheve dhe fazat e veprimit dramatik në dramën e lexuar. | Përmendë situatë konfliktuoze e cila sjell deri te zhvillimi i veprimit dramatik si dhe fazat e veprimit dramatik i ndërlidh me ndonjë ngjarje në dramën e lexuar. | Përmend shkakun e konfliktit mes personazheve në dramën e lexuar: | | |
| | Identifikon aktin, pamjen dhe skenën që nga çasti kur ngrihet perdja deri në mbylljen e saj. | Përmendë pjesët më të vogla të një vepre dramatike. | Në sa akte ndahet pjesa e një vepre dramatike: a) 1, 3 dhe 5 b) 2, 3 dhe 6 2. Cila është njësia më e vogël e një vepre dramatike: a) skena b) pamja | | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|-------|--|---|--|---|--------|
| | Llojet shkencore- letrare Udhëpërshkrimi Reportazha | REN: Bën dallimin mes llojeve letrare-shkencore: udhëpërshkrimit dhe reportazhës. | Saktë përcakton karakteristikat e udhëpërshkrimit dhe reportazhës. | Lidhi llojet shkencore-letrare me specifikat e tyre: udhëpërshkrim - përshkrimi i zonave të vizituara, natyrës, njerëzve, kulturës. reportazha - tekst gazetaresk për përshkrimin e ndonjë udhëtimit. | |
| | | Identifikon llojet e teksteve letrare-shkencore. | Në tekstin e dhënë njih karakteristikat e udhëpërshkrimit dhe reportazhës. | Peisazhi i liqenit të Pogradecit jepet në qetësi. Çdo gjë paraqitet e zymte. Mungon jeta, lëvizja dhe energjia e të rinjve. Liqeri është i pafund, i vendosur midis maleve, lëndinave dhe një hapësire të gjërë të mbuluar nga akulli. Ai është i pakufijshëm, është i thellë. Qëndroj para tij dhe shoh pulëbardhat që fluturojnë. Sa të bukura janë! Më pas vjen perendimi i diellit dhe më pas vjen rënia e natës, një pëlhure si një hije. Sa i bukur është atdheu im, me kaq peisazhe të bukura. Është i vetmi vend ku njeriu ndihet i plotësuar dhe i lumtur. Do doja të qëndroja për një kohë të gjatë duke parë atë peisazh mahnitës, por fatkeqësisht duhet të kthehesha në qytetin tim, megjithëse ai peisazh do ngelet gjatë në mendjen time. Teskti është pjesë e: a) udhëpërshkrimit b) reportazhës | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|--|--|---|---|---|--------|
| <p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA</p> | <p>Të shprehurit me shkrim Aplikime, deklarata, formularë zyrtarë, shkresa</p> | <p>REN: Respekton rregullat e konverzimit gjatë të shkruarit : deklarata, formularë zyrtarë, formularë sipas udhëzimeve të dhëna.</p> | <p>Në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë plotëson formularë, aplikime.</p> | <p>Plotësoni formularin me të dhënat personale: Të dhënat e parashtruesit të Kërkesës: (të plotësohen vendet e zbrazura)</p> <p>Emri dhe mbiemri: _____ (shkruhet me shkronja të shtypit) ADRESA e banimit të parashtruesit – sipas të dhënave nga dokumentit me afat valid _____</p> <p>NUMRI i dokumentit për identifikim _____</p> <p>VENDI dhe DATA, e dhënies se dokumentit të identifikimit _____</p> <p>Organi kompetent, i cili ka dhënë dokumentin e identifikimit _____</p> <p>Vendi, _____, PARASHTRUES, Data _____ Viti _____</p> | |
| | | <p>Respekton rregullat e konverzimit me shkrim gjatë të shkruarit e deklaratës.</p> | <p>Në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë shkruan deklaratë.</p> | <p>DEKLARATË</p> <p>Unë, _____ nga _____ (emri dhe mbiemri) (Vendi dhe komuna) me vendbanim të përhershëm në rr. _____ nr. _____, NP _____ dhe nr. i letërnjoftimit _____, e dhënë në vitin _____, DEKLAROJ me përgjegjësi të plotë morale, personale dhe penale se unë do t'i paguaj gjitha harxhimet për dëmet e mundshme në Shtëpinë studentore nga ana e vajzës/djalit tim _____, Nxënësi-ja në _____</p> <p>(emri i shkollës së mesme) e pranuar për akomodim dhe ushqim në Shtëpinë studentore, në përputhje me "Konkursin për pranimin e nxënësve në institucionet publike studentore në Republikën e Maqedonisë për vitin shkollor 2016/2017" Prindi- Data _____ 2016 Kujdestari</p> | |

| Fusha | Tema/Përmbajtja | Rezultate nga të nxënit për nivelin 6 | Kritere për vlerësim | Shembuj nga detyrat | Niveli |
|---|---|---|---|---|--------|
| KULTURA E MEDIAS | Film Mjetet shprehëse të filmit: fjalimi, aktrimi, muzika, kozmetikë, efektet tingullore, maska. | REN: Njeh fillimet e artit filmik në botë. | Përmendë emrat e themeluesve të artit filmik në botë. | Kush e zbuloi filmin: a) Vëllezërit Lymyer b) Vëllezërit Manaki | 6 |
| | | REN: Njeh fillimet e artit filmik në Maqedoni | Përmendë emrat e themeluesve të artit filmik në Maqedoni | Kush janë themeluesit e filmit në Maqedoni: a) Vëllezërit Lymyer b) Vëllezërit Manaki | |
| | | E kupton domethënien e zërit në film. | Njeh etapat e zhvillimit të filmit. | Filmat e Çarli Çaplinit janë: a) filma të pazëshëm b) filma të zëshëm | |
| | | Emërton aktorët më të famshëm në kohët e fundit. | Përmendë emra të aktorëve të njohur nga bota dhe Maqedonia. | Aktori juaj i preferuar është: _____ | |
| | | Dallon muzikën e filmit (muzikën e dedikuar për film) nga muzika komerciale. | Përmendë këngëtarë të njohur në muzikën e filmit | Cila është muzika ose kënga juaj e preferuar e një filmi _____ | |
| | | E kupton rolin e efekteve tingullore, maskës dhe kozmetikës në film. | Përmend filma me efekte intenzive tingullore, me maskë dhe kozmetikë që len përshtypje. | Në cilin film keni hasur me maskë aktorët: _____ | |
| Filmi Adaptimi filmik i veprës letrare | REN: E kupton definicioni "adaptimi filmik i veprës letrare". | Përmend romane dhe drama përmbajtjet e së cilave kanë qenë të përshtatura në film. | Sipas gjatësisë filmat ndahet në: a) të gjatë, të mesëm dhe të shkurtër b) të mëdha, të vegjël | | |
| | Krahason veprën letrare me atë filmike. | Përmend adaptimin filmik në veprën letrare (dramë, roman) dhe posedon qëndrim personal për dallimet në përshtypjet që len vepra letrare ose filmi mbi lexuesin apo shikuesin. | Cili aktivitet ju jep përshtypje më të madhe dhe PSE? a) të shikoni një film apo b) të lexoni një roman _____ _____ _____ _____ | | |

Република Северна Македонија
Министерство за образование и наука



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Arsimit dhe Shkencës



Empowered lives
Resilient nations.